



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

RREGULLORE MBI TRANSPARENCËN

Në mbështetje të neneve 12 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr.03/L-15 për qasje në dokumente publike i datës 07 tetor 2010, Udhëzimit Administrativ nr.01/2015 për transparencë Komuna , neneve 20, 63, 64 dhe 65 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 si dhe Shkresës së MAPL-së 0-119611 të datës 09.10.2017 , Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 31. 01. 2018, pas shqyrtimit të propozimit Rregullores nga Kryetari i Komunes miratoi këtë:

RREGULLORE MBI TRANSPARENCËN

KAPITULLI I Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është:

- 1.1, Forcimi i transparencës në punët e organeve të Komunës: Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, organeve të Administratës: drejtorive komunale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, punës së ndërmarrjeve publike lokale dhe rritjes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal;
- 1.2 Të krijojë rregullat që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të kësaj të drejte,
- 1.3 Të nxitë praktika të mira administrative për qasje në dokumente zyrtare.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore, rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij, mbledhjet e publikut, obligimin për njoftim publik, konsultimi i akteve komunale dhe publikimi i tyre, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje, qasja e publikut në dokumentet zyrtare të Komunës si dhe transparenca në prokurimin publik.

Neni 3 Përkufizimet

Përkufizimet e kësaj rregullore janë:

- 3.1 **"Seancat e Kuvendit Komunal"**- Janë mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të anëtarëve të Kuvendit të Komunës ,
- 3.2 **"Komitetet"**-Janë trupa të zgjedhur nga Kuvendi i Komunës.
- 3.3 **"Pjesëmarrja e publikut"**- Do të thotë angazhimi i qytetarëve në vendimmarrje të organeve të pushtetit lokal,
- 3.4 **"Njoftimi i publikut"**- Do të thotë afishimin e njoftimeve në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e kuvendit të komunës , publikimin e tyre në media lokale dhe internet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës të Komiteteve, të organeve administrative, të institucioneve arsimore, shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike lokale.
- 3.5 **"Tubimet publike"**- Janë tubime të organizuara nga organet e Komunës me qëllim të njoftimit të qytetarëve me punën e organeve të komunës dhe ngritjen e çështjeve të ndryshme nga banoret,
- 3.6 **"Peticionet"**- Janë kërkesa kolektive me shkrim që i adresohen Komunës respektivisht Kuvendit të Komunës nga një grup i interesit apo organizata, rreth së cilës çdo çështje që ka të bëjë me përgjegjësitë e komunës me qëllim që ajo të ndërmarrë ndonjë veprim ose përmbahet nga ndonjë veprim,
- 3.7 **"Konsultimi publik i akteve komunale"**- Nënkupton seanca dëgjimore, marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të aktit.
- 3.8 **"Qasja në dokumentet zyrtare"**- Nënkupton shikimin e dokumenteve zyrtare të Knë pajtim me Ligjin për qasje në dokumentet publike.
- 3.9 **"Plani i veprimi"** – Nënkupton hartimin e një plani operacional të Kryetarit të Komunës dhe të Kuvendit.
- 3.10 **"Prokurimi Publik"**- Janë rregulla dhe procedura të përcaktuara në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik, për të lidhur kontratë ndërmjet Autoritetit kontraktues (Komunës) dhe Operatorëve Ekonomik, qoftë për furnizim, shërbim apo punë.

Neni 4

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

- 4.1 Mbledhjet e Kuvendit Komunës janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
- 4.2 Kuvendi i Komunës sipas mundësive buxhetore, mund të bëjë transmetim të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
- 4.3 Kuvendi i Komunës nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njofton publikun të paktën 7 (shtatë ditë), para mbledhjeve të rregullta ose 3 (tre ditë), para mbledhjeve të jashtëzakonshme, .
- 4.4 Njoftimi publik bëhet përmes:
- 4.4.1. Shpalljes publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës
 - 4.4.2. Mediave të shkruara dhe elektronike
 - 4.4.3. Uebfaqes së Komunës dhe rrjeteve sociale
- 4.5 Njoftimi me shkrim për publikun përmban:

- 4.5.1. Datën e mbajtjes së mbledhjes
- 4.5.2. Kohën e mbajtjes së mbledhjes
- 4.5.3. Vendin e mbajtjes së mbledhjes
- 4.5.4. Rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.
- 4.6 Mbledhjet e Kuvendit Komunës mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht vetëm për shkaqet e parashikuara me ligjin në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi Komunal i shpallë mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.
- 4.7 Të gjitha vendimet normative dhe kolektive të Kuvendit të Komunës, duhet të bëhen publike, një javë pas mbledhjes në të cilën janë marrë vendimet, si vijon:
 - 4.7.1. Shpallje publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
 - 4.7.2. Medieve të shkruara dhe elektronike lokale,
 - 4.7.3. Faqes të internetit të Komunës.
- 4.8 Buxheti Komunës dhe Planet e Komunës janë dokumente publike. Komuna merr masa për t'ivënë në dispozicion të publikut, mjeteve të informimit dhe grupeve të interesit për çështjen që është objekt i diskutimit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Mbledhjet e Komiteteve të Kuvendit

- 5.1 Mbledhjet e Komiteteve të Kuvendit Komunal janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe grupeve të interesit për çështjen që është objekt diskutimi sipas legjislacionit në fuqi.
- 5.2 Komitetet nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njoftojnë publikun 7 (shtat ditë), para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimi për publik duhet të përmbajë: datën e mbledhjes, kohën e mbledhjes, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës.
- 5.3 Të gjitha vendimet e Komiteteve publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasjen në dokumentet zyrtare duhet t'i vihen në dispozicion të publikut sipas kërkesës.
- 5.4 Komiteti mund të organizojë dëgjime publike me qytetarë dhe grupe të interesit për çështjetme të cilat merret komiteti përkatës.

Neni 6

Publikimi i akteve

- 6.1 Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumente të tjera të kuvendit të komunës. Publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit përkatës për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun.
 - 6.1.1 Shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara, brenda teritorit të Komunës
 - 6.1.2 Mediave të shkruara dhe elektronike
 - 6.1.3 Ueb faqes zyrtare të Komunës dhe rrjeteve sociale

6.2 Poashtu Komuna obligohet të publikoj në ueb faqe zyrtare edhe:

- 6.2.1 Plani i buxhetit dhe Planet investuese
- 6.2.2 Raportet tremujore të shpenzimeve buxhetore
- 6.2.3 Kornizën afatmesme të buxhetore
- 6.2.4 Raportin përmbledhës të buxhetit të Komunës për vitin e kaluar fiskal
- 6.2.5 Raportin e Auditorit të përgjithshme mbi buxhetin e komunës për vitin e kaluar fiskal
- 6.2.6 Kontratat e lidhura ndërmjet Autoritetit kontraktues (Komunës) dhe Operatoreve Ekonomik, qoftë për furnizim, shërbim apo punë.

Neni 7

Peticionet

- 7.1 Çdo qytetar, organizatë ka të drejtë të iniciojë Peticion Kuvendit për veprimtarinë dhe përgjegjësitë e Komunës. Peticionet duhet t'i drejtohen Kuvendit Komunal dhe të dorëzohen në zyrën e Drejtorit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.
- 7.2 Drejtori i Administratës së Përgjithshme, çdo Peticion të vlefshëm duhet t'ia paraqesë Kuvendit Komunal brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit ose në takimin e radhës të Kuvendit. Kuvendi Komunal është i obliguar që t'i shqyrtojë Peticionet dhe të marrë vendim brenda 6 javësh nga paraqitja e tij.
- 7.3 Me Peticion të parashtruar mund të trajtohet secila çështje që është në interes të qytetarëve në kuadër të kompetencave të Komunës.
- 7.4 Peticioni duhet të përmbajë gjeneralitetet si dhe adresën e organizatorit, emrat, mbiemrat, numrin e letërnjoftimit dhe adresën e nënshkruesve të petitionit. Peticioni duhet të përmbajë objektin e çështjes që kërkohet të shqyrtohet nga Kuvendi Komunal duke marrë një vendim meritor për çështjen e ngritur.
- 7.5 Organizatori ose grupi mund ta marrë fjalën në çdo takim të Kuvendit ose të ndonjë Komiteti ku shqyrtohet Peticioni. Arsyetimi para Kuvendit apo Komitetit është e mirë dhe e rëndësishme për të ndikuar në vendimin përfundimtar.
- 7.6 Kuvendi Komunal brenda afatit të përcaktuar në nenin 6.2 e sjell vendimin. Vendimi i komunikohet organizatorit, qytetarët janë të lirë të vazhdojnë të mbrojnë qëndrimet e tyre, nëse përpjekja dështon herën e parë do të mund të jetësohet herën tjetër.

Neni 8

Takimet me publikun

- 8.1 Kuvendi i Komunës është i obliguar që të mbaj të paktën dy takime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm.
- 8.2 Njëri tubim mund të mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa tjetri në gjashtëmujorin e dytë.
- 8.3 Kuvendi Komunal mbanë edhe takime shtesë për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit të Komunës, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës së

komunës, planifikim hapësinor, investimet, të hyrat e komunës etj. Këto takime duhet të mbahen sa më afër qytetarëve, në fshatra dhe lagje të Komunës së Lipjanit

8.4 Kuvendi i Komunës përmes zyrës përgjegjëse për informim informon publikun si vijon:

8.4.1. Afishimi i shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,

8.4.2. Njoftimi i medieve të shkruara dhe elektronike,

8.4.3. Azhurnimi permanent në ueb-faqen e internetit të komunës.

8.5 Njoftimi i publikut bëhet të paktën 14 (katërmëdhjetë) ditë para ditës së tubimit. Njoftimi publik sipas nenit të mëparshëm 8.4 duhet të përmbajë këto të dhëna (datën e mbledhjes, kohën e mbledhjes, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës).

8.6 Pjesëmarrja është e obliguar e zyrtarëve të lartë të Komunës (kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, kryesuesi i kuvendit dhe drejtorët e drejtorive),

8.7 Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë takimit publik, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së takimit.

8.8 Për çdo takim publik mbahet procesverbali i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit e komunës, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.

8.9 Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit, e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa. Komiteti e analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bënë rekomandimet e nevojshme, të cilat i'a propozon Kuvendit të Komunës.

Neni 9

Takimet e Kryetarit të Komunës me qytetarët

9.1 Kryetari i Komunës nuk do të kufizohet vetëm në dy takimet me qytetarë të caktura në nenin 8 pika 8.1

9.2 Kryetari i komunës në kuadër të kompetencave të tij obligohet të mbajë takime me qytetarë sipas nevojës dhe kërkesave të qytetarëve. Ato mund të jenë:

9.2.1. Për projektet në infrastrukturë

9.2.2. Për shërbimet publike

9.2.3. Për shfrytëzimin e pronës komunale

9.2.4. Zhvillimin ekonomik

2.3 Të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës që ndikojnë drejtpërdrejt në interesat e qytetarëve duhet të jenë publike në uebfaqen zyrtare të komunës

Neni 10

Konsultimi publik lidhur me aktet komunale

10.1 Të gjitha dokumentet (aktet, rregulloret dhe vendimet normative) të Kuvendit të Komunës të cilat janë me interes për qytetarët i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen. Organi përgjegjës që propozon dokumentin cakton mënyrën e

konsultimit me grupet e interesit, seancat dëgjimore për publikun dhe forma tjera të pjesëmarrjes së publikut.

10.2 Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun 14 (katërbëdhjetë) ditë para seancës së konsultimit publik si më poshtë:

10.2.1. Afishimi i shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,

10.2.2 Njoftimi i medieve të shkruara dhe elektronike lokale,

10.2.3. Azhurnimi permanent në ueb-faqen e internetit të komunës dhe rrjete sociale.

10.3 Njoftimi publik sipas nenit 10.2 duhet të përmbajë domosdoshmërisht (datën e mbledhjes, kohën e mbledhjes, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës).

10.4 Organi kompetent që ka propozuar aktin duhet të marrë pjesë aktivisht dhe të sqaroj përmbajtjen e aktit para publikut.

10.5 Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve duhet të evidentohen. Propozimet shqyrtohen brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga përfundimi i konsultimit.

10.6 Organi që ka propozuar aktin duhet të informojë kuvendin për propozimet e dhëna në diskutim publik duke përfshirë propozimet e refuzuara si dhe ato të marra parasysh. Merastin e miratimit të aktit, Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projekt-aktit.

KAPITULLI II

Neni 11

E drejta e publikut për qasjen në dokumentet zyrtare të komunës.

11.1 Cili do person fizik apo juridik ka të drejtë në qasje të dokumentëve të organëve komunës, duke ju nënshtuar Ligjit për Vetqeverisje Lokale, Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Statutit të Komunës.

11.2 Kjo Rregullore vlenë për të gjitha dokumentet që mbahen nga organet e komunës, të hartuara apo të pranuar nga këto organe, për të gjitha fushat dhe aktivitetet e Komunës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe

11.3 Kërkesa për qasje në dokumente publike parashtrohet në çfarëdo mënyre, e cila i mundëson institucionit publik të identifikoj dokumentin. Parashtruesi nuk është i detyruar të paraqesë arsyet për parashtrim të kërkesës.

11.4 Nëse kërkesa nuk është e saktë lidhur me informacionin që kërkohet, organi kërkon nga parashtruesi që të qartësoj kërkesën

11.5 Organet e Komunës obligohen që brenda shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të kërkesës të nxjerrin vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japin përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtëm

11.6 Afati për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike mund të vazhdohet deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë, në qoftë se dokumenti publik kërkohet

jashtë organeve të komunës, dhe nëse përmes një kërkesë kërkohen disa dokumente publike

11.7 Në rast se organet e komunës nuk përgjigjen brenda afatit kohor të përcaktuar, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të filloj procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit apo institucioneve tjera publike, gjykatës kompetente në përputhje me ligjin në fuqi.

11.8. Komunitat obligohen që për kërkesat për qasje në dokumente publike të raportojnë në baza periodike dhe vjetore.

Neni 12

Plani i veprimit për transparencë

12.1 Komuna e Lipjanit obligohet që çdo vit të hartoj Planin e Veprimit për Transparencë, i cili pas miratimit të Kuvendit të Komunës publikohet në ueb faqe të Komunës

12.2 Plani i Veprimit për Transparencë ka për synim t'i ofroj publikut qasje në monitorim dhe zbatim të akteve të komunës, duke përfshirë menaxhimin e financave të komunës, prokurimin dhe sfera tjera të cilat janë në interes për publikun

KAPITULLI III

Neni 13

Përgjegjës për zbatim

13.1 Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregullore është Kuvendi i Komunes dhe Kryetari i Komunes

Neni 14


Dispozitat përfundimtare

14.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja Nr. 15-011-24892, datë 30.06.2014

14.2 Kjo Rregullore hynë në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 011-6523
Lipjan, më 01. 02. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



KRYESUESI I KUVENDIT
Daut Azemi